



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr 162/1 Prot

Tiranë, më 28.01. 2020

VENDIM

Nr. 2, datë 28.01.2020

"PËR

MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTAREVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË DHËNIES SË GRADES SHKENCORE "DOKTOR" DHE KOMISIONIT PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK"

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, germa c dhe ç, VKM Nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", pika 18, Statutin e UPT, neni 10, pika 2, gërma g, propozimin e Administratorit të Institucionit me shkresën Nr.151 Prot, datë 28.01.2020, Senati në mbledhjen e datës 28.01.2020, pasi diskutoi propozimin e Administratorit të UPT për masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të përhershme,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e shpërblimit për anëtarët dhe sekretarin e komisioneve të përhershme si më poshtë:

a. KOMISIONI PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të shpërblehen në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë për mbledhje dhe sekretari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, deri në 9 (nëntë) mbledhje në vit, pavarësisht numrit të mbledhjeve të realizuara.

b. KOMISONET E PËRHERSHME TË DHËNIES SË GRADES SHKENCORE "DOKTOR"

Anëtarët e Komisioneve të Përhershme të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" të shpërblehen në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje dhe sekretari

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për mbledhje, deri në 9 (nëntë) mbledhje në vit, pavarësisht numrit të mbledhjeve të realizuara.

2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e masës së shpërblimit për Komisionet, sipas përcaktimeve të pikës 1 (një) a, b të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al